



**Bashkimi Evropian
Instrumenti për ndihmën Para- Anëtarësimin
Për Zhvillimin Rural – IPARD II**

**NJOFTIM PËR KRITERET E PRANIMIT
TË KËRKESËS PËR PARAPAGESË
Nga Programi IPARD II
Thirrja II & III**

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural e Shqipërisë bën me dije procedurën dhe kriteret e pranimit të Kërkesës për Parapagesë, në kuadër të Programit IPARD II nga Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimin (IPA) për Zhvillimin Rural (IPARD) me qëllim të zhvillimit të Sektorit të Agro Ushqimor, si më poshtë:

- a) Pagesa paraprake cilësohet nga autoriteti kontraktues si shpenzim i pranueshëm deri në 50% të ndihmës publike të lidhur me projektin.
- b) Përfituesi ka të drejtë që brenda një muaji nga firmosja e kontratës të kërkojë pagesë paraprake deri në 50% të ndihmës publike.
- c) Çdo pagesë paraprake do të nënshtrohet vendosjes së një garancie bankare ose ekuivalente me të. Vlefshmëria e garancisë duhet të jetë deri në 6-muaj nga data e përfundimit të investimit të përcaktuar në kontratë dhe duhet të korrespondojë 110% të shumës së parapaguar.
- d) Pagesat paraprake lidhur me projekte:
 - Deri më 20% të ndihmës publike dhe;
 - Nuk kalojnë shumën 100.000 Euro

Janë të pranueshme dhe do të nënshtrohen vendosjes së një garancie bankare apo garancie ekuivalente me këtë të fundit (policë sigurimi)

- e) Pagesat paraprake lidhur me projekte kur:
 - Përbëjnë nga 20% deri më 50% të ndihmës publike dhe/ose;
 - Kalojnë vlerën 100.000 Euro

Janë të pranueshme, por detyrimisht do të nënshtrohen vendosjes së një garancie bankare.

Nëse ndonjë nga dokumentat e kërkuara mungon ose është i paplotë nga ana administrative, përfituesi do të njoftohet me shkrim për të ridorëzuar ose plotësojë dokumentet brenda 15 ditëve kalendarike. Nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati, kërkesa për parapagesë do të refuzohet.

Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur lidhur me kriteret e pranimit në udhëzuesin për Aplikantët, i cili mund të kërkohet si një kopje e printuar në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00-16:30.

Kemi evidentuar paqartësi në formën dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës për parapagesë dhe qartësojmë sa më poshtë:

**Për thirrjen e dytë, përfituesi ka të drejtë vetëm një herë brenda një muaji nga firmosja e kontratës të kërkojë pagesë paraprake.*

**Për thirrjen e tretë, përfituesi ka të drejtë vetëm një herë brenda tre muajsh nga firmosja e kontratës të kërkojë pagesë paraprake.*

Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët mund të shkarkohet nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al dhe <http://www.bujqesia.gov.al>

Kontaktet:

Tel: 0800 83 83

Email: info@azhbr.gov.al